



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 65

Prishtinë, më 11 nëntor 2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Skënder Hyseni, Sabri Hamiti, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi, Hamza Balje.

Munguan: Enis Kervan, Berat Buzhala.

Pjesëmarrës të tjerë: Dren Doli – Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Arsim Krasniqi – Kolegji “Fama”, Fjolla Gashi – praktikante dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe praktikantja Gurjeta Zeka.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 20 shtator dhe 1 tetor 2013;
3. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare;
4. Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Kosovës, për vitin 2013;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 20 shtator dhe 1 tetor 2013

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi njëzëri procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 20 shtator dhe 1 tetor 2013.

3. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare

Albin Kurti – I njoftoi të pranishmit se Komisioni, me propozim të grupit të punës, ka angazhuar ekspertin Dren Doli, nga instituti Grupi për Studime Juridike dhe Politike, që ta përgatitë një ekspertizë,

lidhur me zbatimin e Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare. Ekspertiza parashihet të miratohet nga Komisioni, dhe do t'i shërbejë grupit të punës për përgatitjen e raportit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit në fjalë.

Hydajet Hyseni – Njoftoi se grupi i punës ka marrë një detyrë për mbikëqyrjen zbatimit të ligjit, sipas obligimeve që ka edhe në aktivitetin parlamentar, por edhe në Raportin e Progresit, duke shtuar se grupi i punës, nuk ka mundur ta përmbushë planin e punës, për shkak të pushimeve verore dhe fillimit të fushatës zgjedhore. Shtoi se janë bërë disa aktivitete, është vendosur komunikimi i rregullt me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe me institucionin e Presidentit, janë marrë informatat e duhura, të cilat janë në fazën e përpunimit dhe të finalizimit. Theksoi se mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji është specifike, për shkak të faktit se edhe vet çështja është specifike. Ligji në fuqi ka mangësi që derivohet edhe nga dispozitat kushtetuese. Më tej, ai shtoi se grupi i punës ka pasur qasje konstruktive, është evituar çfarëdo politizimi dhe raporti do t'i prezantohet Komisionit për shqyrtim, para se të përfundohet.

Dren Doli – E falënderoi Komisionin për besimin e dhënë. Tha se gjatë analizës janë fokusuar në tri çështje kryesore, siç janë: përmbajtja e ligjit, vlerësimi i zbatimit të tij nga qeveria dhe fokusimi në disa marrëveshje. Pengesë kryesore gjatë vlerësimit kanë qenë mospërgjigjet në kohë nga ministritë lidhur me mënyrën se si ato kanë menaxhuar procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Po ashtu, problem ka paraqitur edhe hyrja në fuqi e ligjit, e cila është bërë më 31 dhjetor 2011, ku ligji nuk ka determinuar, nëse ky ligj vlen edhe për marrëveshjet të cilat kishin filluar të negocioheshin në kohën para se ky ligj të hyjë në fuqi. Ai ceku nenin 6 dhe nenin 7 të ligjit, duke thënë se janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, pasi që neni 6 i jep të drejtë një kategorie të zyrtarëve që të bartin fuqitë e plota me rastin e negocimit, kurse neni 7, këtë të drejtë e kushtëzon me një procedurë tjetër të autorizimit nga ana e presidentit apo nga ana e ministrit për Punë të Jashtme. Çështja tjetër ka të bëjë me procedurën e autorizimit të negociatave. Ligji në fjalë njeh vetëm autoritetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, që të autorizojë negociatat në të gjitha fushat, pa marrë parasysh se cili është autoriteti, i cili do ta nënshkruajë atë marrëveshje. Sipas Dolit, një dispozitë që do të duhej të futet në ligj, është që marrëveshjet të cilat mund të kërkojnë ndryshimin e ligjeve, edhe përkundër faktit që nuk hyjnë në autoritetin e Kuvendit, Kuvendi do të duhej ta kishte autoritetin përfundimtar për ratifikim. Më tej, shtoi se neni 10, paragrafi 5 i ligjit është i panevojshëm, sepse në të thuhet se marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga presidenti, nuk konsiderohen të ratifikuara, kurse Kushtetuta e bën të qartë se të gjitha ato marrëveshje ndërkombëtare, të cilat nënshkruhen nga presidenti, konsiderohen të ratifikuara. Duke iu referuar Marrëveshjes për Energji dhe Telekomunikacion, ai tha kjo marrëveshje po konsiderohet se është në fuqi, duke iu referuar tekstit të marrëveshjes së 19 prillit, ku thuhet që palët do të duhej që deri në një datë të caktuar, të bien dakord mbi një marrëveshje, ndërsa të rënit dakord që një marrëveshje të negociohet, nuk do të thotë që Kuvendi ka rënë dakord që teksti dhe përmbajtja e asaj marrëveshje duhet të ketë fuqinë e ligjit

Skënder Hyseni – Tha se z. Doli gjatë prezantimit të tij, u përqendrua më shumë në përmbajtjen e ligjit, sesa në zbatimin e tij. Shtoi se problemi me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare, është moszbatimi i ligjit, e jo vet ligji si i tillë, dispozitat e cekura si të panevojshme, janë të nevojshme, ngase krijojnë një kujtesë institucionale. Ligji ekzistues për marrëveshjet ndërkombëtare, tha se në 95% të rasteve është i mirë, edhe pse ka hapësirë për modifikime dhe përmirësime, mirëpo është i pakënaqur me zbatimin e këtij ligji. Kosova si shtet i ri ka nevojë për një disiplinë të theksuar në krahasim me shtetet tjera në rrafshin e kontraktualitetit ndërkombëtar.

Sabri Hamiti – Tha se ekspertiza e ofruar e ka vlerën e një dokumenti pune për Komisionin. Më tej, shtoi se mund ta pranojmë këtë dokument, t'i ofrohet grupit të punës, dhe bashkë me rekomandimet e grupit të punës, t'i paraqitet Komisionit për shqyrtim dhe pastaj në rekomandimet, mund të shihet se a duhet të merremi më shumë me ligjin apo me zbatimin e tij. Si të rëndësishëm e cilësoi faktin se a është

zbatuar ky ligji ashtu siç është. Më tutje, theksoi se detyrim i çdo komisioni parlamentar është që të ofrojë vërejtje precize rreth zbatimit të ligjit.

Hydajet Hyseni – I shprehu mirënjohje ekspertit, z. Doli për punën gjithëpërfshirëse dhe profesionale. Tha se në praktikën tonë është përzier kuptimi i traktateve dhe marrëveshjeve institucionale, duke shtuar se edhe Kushtetuta edhe ligji janë të paqarta, dhe në këtë kuptim, mund të ketë keqkuptime. Po ashtu, kërkon që të sqarohet çështja e ratifikimit dhe e nënshkrimit të marrëveshjeve, ngase nuk është e njëjta gjë dhe po që se sqarohet ky problem, do të evitohet një anomali që ka prodhuar rrëmujë në praktikën e ratifikimit të marrëveshjeve.

Donika Kadaj-Bujupi – Falënderoi z. Doli për punën e bërë, duke shtuar se krahas mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, ka arritur t'i shohë edhe ngecjet që janë në ligj. Duke u ndërlidhur me paraqitjen e z. Doli, tha se nëse neni 10, paragrafi 5 është kundër kushtetues, atëherë duhet ta trajtojmë, interpretojmë dhe t'i gjejmë ngecjet që janë në ligj dhe qartësohet se cila është qasja jonë në raport me ligjin dhe zbatimin e tij. Është bërë edhe krahasimi i ligjit të Kosovës me ligjet e vendeve të rajonit, ku përpos Bosnjë dhe Hercegovinës, asnjë vend i rajonit nuk e ka pjesë përbërëse nenin 6. Shtroi pyetjen: Pse Kosova duhet ta ketë atë nen, kur kemi ngecje në zbatim të ligjeve? Tha se raportin e institutit duhet ta trajtojmë, ta vlerësojmë dhe të nxjerrim rekomandimet përkatëse.

Emilija Redzeqi – Kërkoi të informohet nga z. Doli se me cilat ministri nuk ka mundur të bashkëpunojë me rastin e punimit të ekspertizës.

Dren Doli – Duke u ndërlidhur në pyetjet e deputetes Rexhepi, tha se kryesisht Ministria e Punëve të Jashtme dhe ajo e Forcës së Sigurisë, nuk i janë përgjigjur kërkesave të institutit. Po ashtu, tha se raporti kryesisht fokusohet në çështjen e zbatimit të ligjit, sesa në përmbajtjen e tij.

Albin Kurti – E falënderoi Grupin për Studime Juridike dhe Politike për punën e bërë, duke theksuar se këto shpjegime duhet të trajtohen nga grupi i punës, sepse bëhet fjalë për kundërthënie të identifikuar. Një të gjetur të vlefshme e konsideron votimin nga Kuvendi i Kosovës për ratifikimin e marrëveshjes Thaçi – Daçiq, e cila ka paraqitur dakordim që të ketë marrëveshje për çështjen e energjisë, por jo edhe për përmbajtjen e saj. Propozoi që në parim, të miratohet raporti vlerësues për ta trajtuar grupi i punës, i cili më pastaj do të paraqesë raport të përgjithshëm.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti mbi ekspertizën e bërë nga instituti Grupi për Studime Juridike dhe Politike, përfaqësuar nga Dren Doli, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

4. Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Kosovës për vitin 2013

Albin Kurti – Lidhur me raportin, tha se dy vlerësimet kryesore pozitive për Kosovën janë dialogu me Serbinë dhe ligjet e mira, por mungon zbatimi i këtyre ligjeve në praktikë. Këto suksese i sheh më shumë si përmirësim i imazhit të jashtëm, sesa si përmirësim të gjendjes. Një çështje tjetër që do të duhej të ngritej, sepse është e padrejtë dhe e rrezikshme, përdorimi i shprehjes “Northern Kosovo”, pra “Kosova Veriore”, që do të duhej të ishte “north of Kosovo” – “veriu i Kosovës”. Çështjet tjera që përmenden në raport, tha se janë mungesa e llogaridhënies së Qeverisë ndaj Kuvendit, krimi i organizuar dhe korrupsioni, PTK-ja, si dhe konstatimi i gjendjes së rëndë ekonomike dhe sociale. Raporti, problematike e konsideron lidhjen e nivelit politik me atë të menaxhmentit të policisë, punësimin e zyrtarëve publikë në dy e më shumë vende pune. Më tej, ai shtoi se në raport thuhet që reforma në administratën publike karakterizohet me mungesë të profesionalizmit dhe të motivimit. Sipas raportit, rastet në pritje gjyqësore janë shtuar nga 218.714 sa kanë qenë vitin e kaluar, tash janë bërë 235.000 dhe

se gjyqësorit i ndahen pak mjete buxhetore, rreth 2% të buxhetit të Kosovës. Po ashtu, shtoi se në raport thuhet se stacionet policore që veprojnë në veri të vendit, po mbyllen gradualisht dhe se nuk ka shenja të veprimit operacional, se autoritetet serbe i kanë pushuar pagesat e pagave për zyrtarët serbë që janë të punësuar në Policinë e Kosovës dhe se integrimi i serbëve të Kosovës nga radhët e zyrtarëve të policisë, gjykatësve dhe prokurorëve të punësuar më herët nga autoritetet serbe, po vazhdon. Si sukses në raport paraqitet shpërbërja e kuvendeve komunale në katër komunat veriore, por nga raportimet në media vërehet se kjo nuk është e vërtetë, sepse ato nuk janë shpërbërë.

Hydajet Hyseni – Propozoi që të bëhet diskutim në parim, por tha se do ishte mirë që Raportin e Progresit ta analizojnë nga këndvështrimi i Komisionit, për të nxjerrë detyrat nga fusha e komisionit. Tha se imazhi i Kosovës po deformohet më shumë, sesa që është, për qëllime ndonjëherë politike, ndonjëherë të përfitimit të projekteve të ndryshme, sidomos në fushën e ndjeshme të të drejtave të minoriteteve. Më tej, shtoi se Kuvendi ka marrë shumë kritika për organizimin e një debati për një rast të drejtësisë, i cili po cilësohet si ndërhyrje në gjyqësor, duke shtuar se Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në mbledhjen e fundit të saj, ka miratuar një rezolutë për rastin Magnicki, veprim të cilin askush nuk e quajti ndërhyrje në gjyqësor, pasi që qasja nuk ka qenë e natyrës së tillë. Nuk duhet lejuar që Kosova të kritikohet për diçka që e bëjnë të gjithë, jemi të thirrur ta bëjmë, shtoi më tej. Shprehu mendimin se Komisioni për Punë të Jashtme duhet të fokusohet në detyrat nga fusha që mbulon. Pra, të gjitha raportet për Kosovën duhet të vijnë në Komision, të shqyrtohen të plotësohen dhe të nxirren rekomandime konkrete.

Albin Kurti – Sqaroi se përshtypja e tij nga leximi i raportit, është se Kosova është paraqitur më mirë sesa që është. Dialogu me Serbinë dhe ligjet e miratuara në përputhje me *acquis communautaire*, ka bërë që Bashkimi Evropian të mbyllë njërin sy. Lidhur me rastin gjyqësor të përmendur nga deputeti H. Hyseni, tha se pajtohet plotësisht, sepse gjykata e EULEX-it nuk është as e pavarur, as e paanshme. Po ashtu, rreth raporteve ndërkombëtare, tha se do duhej të propozohen nga anëtarët e Komisionit dhe ato do të shqyrtohen në mbledhjet e rregullta të Komisionit.

5. Të ndryshme

Albin Kurti – I njoftoi anëtarët e Komisionit se Projektligji për Buxhetin për vitin 2014, i është proceduar Kuvendit dhe propozoi që të shqyrtohet, me ç’ rast do të ftohej ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, në mënyrë që të trajtohet çështja e buxhetit të MPJ-së.

Skënder Hyseni – Pajtohet që të ftohet ministri, që të bisedohet për buxhetin, por edhe për çështjet tjera që lidhen me politikën e jashtme.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Të ftohet ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj, që të raportojë në Komision lidhur me buxhetin dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe zhvillimet në politikën e jashtme.

Takimi përfundoi në orën 11:15.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.